

## **AKT THEMELIMI**

Sot ne dt. 02/02/2025 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

**KLAUDJA BARJAMI** e datelindjes 31-05-1993, e lindur ne Sarande, SHQIPERI, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J35531049Q ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 20/09/2019.

**REI ÇIPA** i datelindjes 03-09-2001, i lindur ne GRC dhe banues ne Sarande, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID K10903109Q ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 26/06/2019, i cili me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**MARVEL 2025**" shpk.

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

#### Neni 1

#### Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **MARVEL 2025** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

#### Neni 2

#### Forma Juridike

Shoqeria **MARVEL 2025**shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **MARVEL 2025** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vierës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

#### Selia

#### **Shoqeria e ka seline ne adresen:**

**Sarande, Lagjja 1, Rruga Butrinti, godina me Numer Pasurie 1/177+1-N4, Zona Kadastrale 2297.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

#### Neni 4

#### **Objekti i veprimtarise**

**Operator turistik, sherbime turistike ne det dhe ne toke. Shetitje me Varke Turistike te pushuesve. Guida te ndryshme turistik**



Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: , **KLAUDJA BARJAMI** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 7,000 Leke, e cila perfaqeson 70 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **REI ÇIPA** , zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 3,000 Leke, e cila perfaqeson 30 % te kapitalit te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per çeshtje te tjera si: emerimin dhe shkarkimin e administratorëve, te likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, percaktimin e shperblimeve, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te perbashket.

Administratoret e shoqerise jane **Z. REI ÇIPA** i datelindjes 03-09-2001, i lindur ne GRC dhe banues ne Sarande, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas

ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID K10903109Q , leshuar nga MPB, Shqiperi me date 26/06/2019

**Z. RENATO PODA** i datelindjes 25-11-1994, i lindur ne Sarande , SHQIPERI, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J41125046M ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 12/09/2022

Administratoret emerohen me nje afat pese vjecar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

#### Neni 11 Kompetencat

Administratoret kane kompetencat si me poshte:

Administratori **Z. REI ÇIPA** ka te gjitha kompetencat e plota dhe te pakufizuara qe te veproje i vetem,i pavarur ne perputhje me statutin dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per te gjitha veprimet e nevojshme lidhur me aktivitetin ekonomik te shoqerise.

**Z. RENATO PODA do te veproj si Administrator i shoqerise dhe do te kete vetem te drejten qe te kryej : Veprimtarine Turistike te Shoqerise, per aktivitetin e lundrimit detar .**

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratoret ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 12 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

- a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b.Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"
- c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### Neni 14 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901

date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe  
çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike,  
ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues  
te shoqerise tregtare **MARVEL 2025** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke  
vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**

**KLAUDJA BARJAMI** **REI ÇIPA**  
  
**ADMINISTRATORET**

**REI ÇIPA** **RENATO PODA**





